Konsultimi publik në Shqipëri 2017-2018



Më 1 Prill 2019, Res Publica prezantoi raportin per zbatimin e ligjit nr. 146/2014 “Per njoftimin dhe konsultimin publik” gjate viteve 2017-2018. Raporti eshte pjese e nje projekti te mbeshtetur nga National Endowment for Democracy, i cili konsiston ne monitorimin dhe vleresimin e proceseve te konsultimit publik, perfshire edhe nje vleresim te punes se Komisionerit per te Drejten e Informimit, si organ kujdestar i ketij ligji.

Ne qender te prezantimit u vu pyetja: A eshte konsultimi publik ne Shqiperi nje ushtrim i çilter i demokracise pjesemarrese apo thjesht nje fasade? Duke bere krahasime me konceptimin e ketij procesi ne vende te ndryshme te Evropes, raporti paraqet shifra per te kuptuar se deri ne cilen shkalle pjesemarrja e publikut ne proceset vendimmarrese eshte e mirepranuar nga qeveria. Ne thelb vihet re se konsultimi publik ne dy vitet e fundit nuk paraqet interes per qeverine, por edhe per vete publikun. Nje numer i madh draftesh nuk konsultohen fare, ndersa per nje pjese tjeter konsultimeve jane vetem fasade. Ne nje numer te vogel rastesh konsultimi ka qene i vlefshem per te dy palet, por numri i organizatave qe zakonisht angazhohen eshte i vogel, ndersa publiku i gjere nuk ka treguar interes. Regjistri elektronik i krijuar per te lehtesuar komunikimin e publikut me qeverine nuk eshte perdorur, jo vetem per shkak te apatise qytetare, por edhe per shkak te ideimit te gabuar te vete regjistrit. Nje numer

rekomandimesh jane listuar ne fund te raportit, me qellim adresimin e shqetesimeve te ngritura. Per t’u njohur me studimin e plote, klikoni ketu per ta shkarkuar.